



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA	
QEVERIA E KOSOVES-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA	
MINISTRIA E SHENDETESISE-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH	
Njësia Org. Org. Jedinica Org Unit	01
Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.	25-1807
Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	-40-
Data: Datum: Date:	13/03/2024
Prishtinë / a	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health
Zyra e Ministrit/Ured Ministra/Office of the Minister

Nr:37/III/2024
Datë:12/03/2024

Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të Nenit 145 (pika 2) e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare Nr. 7, 01 Mars 2019), bazuar në nenin 11 të Ligjit Nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, Rregulloren (QRK) Nr.14/2023, për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Shtojca 1 paragrafi 6 nënparagrafi 6.1, lidhur me shkresën Nr. prot. 05-1655, datë 08.03.2024, nxjerrë:

V E N D I M

- I. Miratohet Plani i Avokimit, Komunikimit dhe Mobilizimit Social për Vaksinat e Reja në Kalendarin e Vaksinimit.
- II. Shtojcë e këtij vendimi është Plani i Avokimit, Komunikimit dhe Mobilizimit Social për Vaksinat e Reja në Kalendarin e Vaksinimit.
- III. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

- *Zavendësministrave;*
- *Sekretarit të përgjithshëm;*
- *IKSHPK;*
- *DZHSSH;*
- *Departamentit ligjor;*
- *Arkivit të MSh-së.*

Dr. Arben Vitia
Ministër i Shëndetësisë





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

**PLANI I AVOKIMIT, KOMUNIKIMIT DHE
MOBILIZIMIT SOCIAL PËR VAKSINAT E REJA NË
KALENDARIN E VAKSINIMIT**

Prishtinë,
Mars, 2024

PËRMBAJTJA

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
2. HYRJE	5
3. METODOLOGJIA	6
3.1.1. Kufizimet dhe rreziqet.....	7
4. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT	7
5. SFONDI	7
5.1.1. Besimi në vaksina.....	8
5.1.2. Vaksinimi në shkolla.....	8
5.1.3. Masmmedia.....	8
5.1.4. Mediat sociale.....	9
5.1.5. Vaksinimi për popullatën vulnerabile.....	10
5.1.6. Komunikimi i brendshëm dhe me palët e interesit.....	10
5.1.7. Sigurimi i transparencës për vaksinimin HPV.....	10
6. ARRITJA E OBJEKTIVAVE-PARIMET DHE VEPRIMET E PLANIT TË KOMUNIKIMIT	11
6.1.1. Përgatitjet e ndërmarra.....	11
6.1.2. Parimet e planifikimit dhe implementimit.....	13
6.1.3. Qasja në faza.....	14
7. MONITORIMI DHE EVALUIMI	15
7.1.1. Monitorimi i zbatimit.....	15
7.1.2. Monitorimi i efektivitetit të veprimeve të Planit të Komunikimit.....	15
7.1.3. Monitorimi i rezultateve.....	16
7.1.4. Evaluimi.....	16
8. ARANZHIMET E ZBATIMIT, MONITORIMIT DHE RAPORTIMIT	16
9. NDIKIMI BUXHETOR DHE ZBATIMI I PLANIT NACIONAL	17
10. PLANI I VEPRIMIT	18
11. SHTOJCAT	18-39

SHKURTESAT

MSH-Ministria e Shëndetësisë

MASHT-Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

IKSHPK-Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës

OBSH-Organizata Botërore e Shëndetësisë

UNICEF-Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë

GAVI-Aleanca Globale e Vaksinimit dhe Imunizimit

PVI -Plani i Veprimit për Vaksinim

AKMS-(Plani) Avokim, Komunikim dhe Mobilizim Social

Vaksina HPV -Vaksina kundër Human Papilloma Virusit

Vaksina PCV -Vaksina kundër Pneumokokut

Vaksina ROTA -Vaksina kundër Rotavirusit

QKMF-Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare

QMF - Qendra e Mjekësisë Familjare

AMF-Ambulanca e Mjekësisë Familjare

OJQ-Organizatë Jo-Qeveritare

GM AKMS-Grupi Monitorues për Avokim, Komunikim dhe Mobilizim Social

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Plani i Avokimit, Komunikimit dhe Mobilizimit Social (AKMS) detajon veprimet dhe përgjegjësitë kryesore që kërkohen për të rritur pranimin publik për përfshirjen e vaksinave kundër Pneumokokut (PCV), Rotavirusit dhe Human Papilloma Virusit (HPV) dhe për të arritur objektivat e mbulueshmërisë gjatë vitit 2024, siç detajohet në Planin e Përfshirjes 2023 të Ministrisë së Shëndetësisë për vaksinën kundër Pneumokokut, Rotavirus-it dhe të Human Papilloma Virusit¹. Ky plan, gjithashtu, detajon veprimet e AKMS që nevojiten të ndërmerren nëse shfaqet hezitimi ndaj vaksinimit ose paraqiten reagime publike kundër vaksinimit dhe/ose situata përshkallëzohet deri në masë ku besimi i publikut në tre vaksinat bie dhe reputacioni i Ministrisë së Shëndetësisë mund të rrezikohet. Në lidhje me popullsinë vulnerabile, Plani i AKMS i përshkruan veprimet e nevojshme për të arritur këto kategori të popullatës dhe vajzat që janë jashtë shkollës. Megjithatë, plani vë në dukje se ekziston një nevojë urgjente për të zhvilluar një qasje afatgjate dhe më të qëndrueshme për arritjen e popullatës vulnerabile me shërbimet e imunizimit dhe rritjen e qasjes dhe kërkesës për shërbimet shëndetësore parësore në përgjithësi të popullata e caktuar.

Veprimet e specifikuar në Planin e AKMS bazohen në provat e disponueshme (përfshirë hulumtimin kualitativ formativ dhe konsultimet me palët e interesit), si dhe në nivelet aktuale të mbulueshmërisë me vaksinim, kapacitetin e akterëve kryesorë sektorialë për të lehtësuar përfshirjen efektive të vaksinave, nivelin e rrezikut dhe disponimin e përgjithshëm të publikut në Kosovë për të pranuar vaksinimin, përfshirë vaksinimin kundër HPV për vajzat në klasën e 6-të. Ky plan bazohet gjithashtu në diskutimet nga punëtorja e bashkë-draftimit të planit, e organizuar nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike me mbështetjen e UNICEF në Kosovë në fund të tetorit 2023. Plani AKMS bazohet në aktivitetet përgatitore të ndërmarra në vitin 2023 duke përfshirë shtrirjen e trajnimeve kaskadë të punonjësve shëndetësorë për prezantimin e vaksinave të reja, trajnimet rifreskuese për punonjësit shëndetësorë mbi komunikimin ndër-personal për vaksinat e reja, konferencën kombëtare për profesionistët shëndetësorë për prezantimin e tri vaksinave shtesë, dhe disa aktivitete të angazhimit në media për vetëdijësimin e popullatës, duke përfshirë diskutime dhe pyetje-përgjigje me profesionistët mjekësorë.

Përgjithësisht, rreziqet për përfshirjen e vaksinave kundër PCV, Rota dhe HPV konsiderohen të ulëta, por të pranishme, veçanërisht pasi ato lidhen me potencialin për hezitim ndaj vaksinës që mund të lind me administrimin e vaksinës HPV. Për të zbutur rreziqet e mundshme, Plani i AKMS propozon një qasje të komunikimit me intensitet të mesëm, komunikim transparent dhe efektiv me publikun e gjerë dhe palët e interesit si dhe përgatitje për çdo reagim eventual kundër vaksinimit që mund të shfaqet ose të përshkallëzohet si pasojë e shfaqjes së vëmendjes dhe prezantimit negativ për vaksinimin nga masmediat, rrjetet sociale apo individë kundër vaksinimit.

Plani i AKMS do të zbatohet në tre faza të veçanta. Faza 1 - thekson zhvillimin e udhëzuesve dhe materialeve të komunikimit; Faza 2 - ka në fokus angazhimin e drejtpërdrejtë me shkollat dhe prindërit përmes shpërndarjes së informacionit kyç, dhe ofrimin e sesioneve të strukturuar informuese ndërmjet profesionistëve shëndetësorë, mësimitdhënësve dhe përfaqësuesve të prindërve; dhe Faza 3- fokusohet në monitorimin dhe reagimin e duhur ndaj reagimeve të

^{1 1 1} Coverage targets are as follows: Rotavirus Vaccine – 92% by 2025, Pneumococcal Vaccine – 92% by 2026, and Human Papillomavirus Vaccines – 90% by 2024.

publikut (veçanërisht prindërve) ndaj vaksinimit në shkolla dhe veprimeve të AKMS, të ndërmarra për të nxitur marrjen e vaksinave.

Prioritetet ndër-sektoriale dhe të vazhdueshme që mbështesin veprimet e AKMS përfshijnë sigurimin e komunikimit të rregullt ndërmjet palëve të interesit në nivel kombëtar dhe komunal, monitorimin e vazhdueshëm të komenteve në media dhe rrjete sociale si dhe angazhimin dhe arritjen e grupeve vulnerable të popullatës.

2. HYRJE

Plani i Veprimit për Vaksinim 2022 – 2025 i Ministrisë së Shëndetësisë së Kosovës përcakton qëllimet dhe objektivat e qarta të imunizimit, dhe detajon se si do të arrihen këto synime dhe objektiva. Një risi e theksuar në PVI 2022-2025 është përfshirja dhe miratimi i tre vaksinave shtesë (PCV, Rota dhe HPV) brenda Kalendarit të rregullt të vaksinimit në Kosovë. Këto vakcina janë:

- Vakcina kundër pneumokokut (PCV) e cila parandalon infeksionin pneumokokal, sëmundjet serioze duke përfshirë meningjtin, septikeminë dhe pneumoninë si dhe sëmundjet e zakonshme, duke përfshirë sinusitin dhe ndezjen e veshit të mesëm (otitis media).
- Vakcina kundër Rotavirusit (Rota) e cila parandalon infeksionin me rotavirus dhe diarrenë e rëndë në fëmijëri, dhe
- Vakcina kundër Human Papilloma Virus-it (HPV) e cila parandalon kancerin e qafës së mitrës dhe një sërë kancere të tjera të lidhura me infeksionin e Human Papilloma Virus-it².

Vaksinat kundër PCV dhe Rota filluan të administrohen në Kosovë në tetor 2023 përmes sistemit të Kujdesit Parësor Shëndetësor, sipas PVI. Vakcina e HPV-së do të futet në sistemin rutinë të imunizimit në shkolla (shih seksionin 4) në shkurt 2024 me një grup të synuar të gjitha vajzave, nxënese të klasës VI-të (me një grup të përgjithshëm të popullsisë të vlerësuar prej 13,000 vajzave). Përpjekje do të bëhen gjithashtu gjatë vitit 2024 për të arritur vajzat 12-vjeçare të pa vaksinuara që nuk ndjekin arsimin përmes bashkëpunimit me QKMF-të, QMF-të dhe AMF-të dhe OJQ-ve që punojnë me grupet vulnerable të popullsisë.

Ndryshe nga vakcina HPV, vaksinat PCV dhe Rota u administrohen foshnjave (PCV në 2, 4 dhe 12 muaj dhe Rota në 2 dhe 4 muaj). Për shkak se vaksinimi i foshnjave është një praktikë e mirë-vendosur, normative dhe e pranuar në Kosovë në mesin e prindërve dhe kujdestarëve, vaksinat kundër PCV dhe Rota kanë filluar të implementohen pa ndonjë dëshmi të frikës apo hezitimit të prindërve/kujdestarit për vaksinim.

Për vaksinën HPV, përvoja globale ka demonstruar një potencial në kontekste të caktuara për hezitim dhe/ose refuzim të vaksinës, kryesisht për shkak se vakcina mund të stigmatizohet për shkak të ndërlidhjes me parandalimin e infeksionit seksualisht të transmetueshëm dhe seksualitetin e adoleshentëve. Në këtë rast, ekziston nevoja për të planifikuar me kujdes veprimet e Avokimit, Komunikimit dhe Mobilizimit Social (AKMS) për administrimin e vaksinës kundër HPV dhe të hulumtohet dhe të merret parasysh se si mund të reagojë publiku ndaj vaksinës.

Plani i AKMS për prezantimin e vaksinës kundër PCV, Rota dhe HPV i kushton vëmendje të veçantë sfidave të AKMS që lidhen me HPV-në, përveç veprimeve thelbësore të AKMS që do

^{2 2} For comprehensive epidemiological information relating to the PCV, Rota and HPV vaccines and their introduction see the MoH 2023 Pneumococcal Conjugate, Rotavirus and Human Papillomavirus Vaccine Introduction Plan (Plani i veprimit për vaksinim 2022-2025).

² For school-based vaccinations the target cohort is all grade 6 schoolgirls, irrespective of age.

² In African countries with past experiences of the mass administration of injectable contraceptives, rumours have also circulated that the HPV vaccine causes infertility. However, the circulation of these rumours in Europe

të kërkohen për përfshirjen e qëndrueshme të tre vaksinave brenda Kalendarit të rregullt të vaksinimit në Kosovë.

Përveç kësaj hyrjeje, Pjesa 2 e Planit të AKMS përshkruan metodologjinë e përdorur; Pjesa 3 paraqet qëllimet dhe objektivat e AKMS; Pjesa 4 detajon informacionin dhe analizën e sfondit në lidhje me prezantimin e vaksinave; Pjesa 5 detajon parimet e planifikimit të përdorura, dhe veprimet e nevojshme për të arritur qëllimet dhe objektivat e AKMS; dhe Pjesa 6 trajton monitorimin dhe vlerësimin. Pjesa 7 paraqet orarin e implementimit të AKMS dhe përcakton përgjegjësitë kryesore.

Për më tepër, Plani i AKMS-së vendos një theks të rëndësishëm në komunikimin ndër-sektorial dhe brenda Ministrisë së Shëndetësisë, IKSHP, ekipeve të vaksinimit dhe QKMF/QMF në gjitha nivelet; dhe mbi komunikimin dhe koordinimin ndër-sektorial ndërmjet sektorëve të shëndetësisë dhe arsimit, dhe ndërmjet të gjithë akterëve relevantë, përfshirë partnerët ndërkombëtarë. Vëmendja ndaj cilësisë, frekuencës dhe saktësisë së komunikimeve të brendshme dhe të palëve të interesit do të jetë thelbësore për të maksimizuar efektivitetin e të gjitha ndërhyrjeve të planit AKMS dhe do të promovojë dhe mundësojë efikasitetin e përgjithshëm të programit, ngritjen e kapaciteteve, qëndrueshmërinë, reagimin dhe nxjerrjen e mësimëve.

3. METODOLOGJIA

Plani i AKMS për përfshirjen e vaksinës kundër PCV, Rota dhe HPV është i ndërtuar mbi praktikatat më të mira globale, një analizë e konteksteve dhe përvojave lokale dhe prioritetëve të akterëve kryesorë, duke përfshirë MSH, IKSHP, GAVI, OBSH dhe UNICEF. Zhvillimi dhe aprovimi i strategjisë ka përfshirë disa hapa kyç, duke përfshirë:

- Zhvillimin e një hulumtimi formativ me mbështetjen e Zyrës së OBSH-së për të kuptuar më mirë pengesat e mundshme për marrjen e vaksinës HPV, duke përfshirë edhe popullatat vulnerable.
- Angazhimin e një konsulenti- ekspert ndërkombëtar nga UNICEF në Kosovë për të bërë rishikimin e evidencës në dispozicion dhe për t'u konsultuar me palët kryesore të interesit nga MSH, IKSHP, OBSH, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë (MASHT) dhe OJQ-të, mbi sfidat, praktikatat më të mira dhe mundësitë kryesore për AKMS.
- Prezantimi i gjetjeve kryesore të konsulentit para palëve të interesit dhe bashkë-draftimi i Planit AKMS për vaksinën kundër PCV, Rota dhe HPV.
- Organizimi i punëtorisë për të diskutuar gjetjet e hulumtimit kualitativ formativ dhe konsultimeve me palët e interesit për planifikimin AKMS.
- Prezantimi i Planit të AKMS nga konsulenti, renditja e veprimeve kryesore të AKMS dhe rishikimi i mëposhëm i Planit nga Grupi Monitorues për AKMS për përfshirjen e vaksinës kundër PCV, Rota dhe HPV
- Prezantimi i Planit para përfaqësuesve të njësive të vaksinimit në nivel vendi
- Rishikimi dhe validimi përfundimtar i Planit për AKMS.

3.1.1 Kufizimet dhe rreziqet

Me gjithë faktin se janë bërë përpjekje për t'u siguruar që Plani i AKMS të jetë i bazuar në prova dhe të pasqyrojë njohuritë dhe përvojën kolektive të gjithë akterëve kryesorë për imunizim, disa elementë rreziku dhe pasigurie (shih seksionin vijues) janë të pashmangshëm; posaçërisht në lidhje me atë se si do të reagojë saktësisht publiku i gjerë (dhe prindërit në veçanti) ndaj përfshirjes së këtyre vaksinave (veçanërisht HPV) në Kalendarin e rregullt të vaksinimit në Kosovë; dhe ndaj intervenimeve të AKMS të ndërmarra për të krijuar besimin në publik. Megjithëse gjasat janë shumë të ulëta, shfaqja arbitrare, prodhimi i dëmshëm ose promovimi i reagimeve kundër vaksinimit si dhe thashethemeve për vaksinat mund të ndodhë dhe, për rrjedhojë partnerët dhe palët e interesit të AKMS do të duhet të jenë të vetëdijshëm për nevojën për të mbetur fleksibil dhe të gatshëm për të parashikuar dhe për t'iu përshtatur rrethanave gjatë përgatitjeve dhe zbatimit të planit të AKMS.

Sidoqoftë, rreziqet dhe pasiguritë e mundshme për vaksinat kundër PCV, Rota dhe HPV janë vlerësuar në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe janë identifikuar veprime dhe taktika për të parashikuar, zbutur dhe adresuar sfidat e AKMS dhe kur ato shfaqen.

4. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT

Qëllimi i Planit të AKMS-së për vaksinat kundër PCV, Rota dhe HPV është të mbështesë arritjen e mbulueshmërisë optimale për grupet e synuara për tri vaksinat shtesë, të ruajë dhe rrisë në përgjithësi besimin e publikut në vaksinim, të promovojë qëndrueshmërinë e Programit të imunizimit dhe të sigurojë që publiku është informuar për efikasitetin e vaksinave kundër PCV, Rota dhe HPV dhe rëndësinë e përfshirjes së tyre në Kalendarin e rregullt të vaksinimit në Kosovë.

Objektivat e Planit të AKMS për përfshirjen e PCV, Rota dhe HPV është të promovojë marrjen e vaksinës kundër PCV, Rota dhe HPV, të menaxhojë kërkesën publike, të rris ndërgjegjësimin për disponueshmërinë dhe efikasitetin dhe sigurinë e vaksinave midis profesionistëve shëndetësorë, mësimdhënësve dhe prindërve, të menaxhojë kërkesën dhe pritshmëritë publike, të krijojë konsensus të palëve të interesit, të udhëheqë komunikimin efektiv të brendshëm dhe ndër-sektorial, të parashikojë dhe adresojë rreziqet dhe të planifikojë një qasje të përgjegjshme dhe fleksibile të implementimit të planit.

5. SFONDI

Plani i AKMS për përfshirjen e vaksinës kundër PCV, Rota dhe HPV bazohet në rezultatet e hulumtimit formativ, një rishikim të provave të disponueshme, konsultimin me palët kryesore të interesit dhe bashkë-draftimin e veprimeve dhe proceseve për të arritur qëllimet dhe objektivat e rënë dakord. Përpara se të përshkruhen veprimet e planifikuara për AKMS është e rëndësishme që fillimisht të shqyrtojmë se çfarë kanë zbuluar provat në lidhje me kontekstin social dhe operacional në të cilin do të prezantohen vaksinat shtesë (PCV, Rota dhe HPV).

5.1.1 Besimi në vaksinim

Gjetjet nga hulumtimi formativ dhe konsultimet me palët e interesit tregojnë fuqimisht se vaksinimi është i pranuar mirë nga publiku kosovar dhe se Institutit Kombëtar të Shëndetësisë

Publike të Kosovës (IKSHPK) i besohet gjerësisht si ofrues i shërbimeve dhe informacioneve për shëndetin publik. Në lidhje me vaksinat kundër PCV, Rota dhe HPV, evidencat sugjerojnë se publiku (dhe prindërit në veçanti) do t'i pranojnë këto vaksina, por me kërkesën e prindërve se do të donin t'u jepeshin informacione rreth vaksinave.

Përvoja e kaluar me administrimin e vaksinës kundër COVID-19, dëshmoi se vakcina u prit përgjithësisht mirë nga popullata e Kosovës, me një shkallë të ulët të hezitimit ndaj vaksinës. Reagimet globale kundër vaksinimit COVID-19 që qarkullonin gjerësisht nuk tërhoqën vëmendje të konsiderueshme në Kosovë gjatë pandemisë, duke sugjeruar se besimi i publikut në programet e vaksinimit në Kosovë është fleksibil dhe se publiku mund të pranojë përfshirjen e një vaccine tjetër potencialisht të diskutueshme (d.m.th., HPV) nëse përfitimet e vaksinës mund të artikulojnë dhe demonstrojnë qartë.

Vajzat, prindërit dhe mësuesit raportojnë se ata kërkojnë informacion shëndetësor kryesisht nga burime të besuara si IKSHPK dhe profesionistët shëndetësor, dhe raportojnë se janë skeptikë për informacionin shëndetësor në mediat sociale ose në internet. Vajzat raportojnë se u besojnë më së shumti këshillave të prindërve të tyre në krahasim me të gjitha burimet e tjera, duke sugjeruar rëndësinë e pranimin të vaksinimit HPV nga prindërit që të jetë implementimi i suksesshëm.

5.1.2 Vaksinimi në shkollë

Ndryshe nga shumë vende të tjera ku vakcina HPV është prezantuar përmes iniciativave të vaksinimit në shkolla, Kosova tashmë ka një program të themeluar dhe të pranuar të vaksinimit të bazuar në shkolla. Në vendet pa një përvojë të vaksinimit të bazuar në shkollë, janë shfaqur tensione midis sektorëve të shëndetësisë dhe arsimit ndaj dhe komunikimi dhe konsensusi ndër-sektorial janë shfaqur si sfida. Megjithatë, në Kosovë vaksinat kundër Difterisë, Tetanusit, Poliomiellitit, Fruthit, Shytave dhe Rubellës administrohen në shkollë nga ekipet e vaksinimit për të gjithë fëmijët e klasës VI-të për shumë dekada. Rrjedhimisht, modaliteti i vaksinimit në shkollë është plotësisht i institucionalizuar, i udhëhequr nga legjislacioni dhe i mbështetur dhe i pranuar nga nxënësit, prindërit, mësuesit, administratorët dhe drejtorët e shkollave, autoritetet komunale shëndetësore dhe arsimore, si dhe MASHT dhe MSH.

Duke pasur parasysh pranimin e vaksinimit në shkollë, është e arsyeshme të supozohet se vajzat dhe djemtë janë socializuar për të pranuar vaksinimin në shkolla. Pasi ata kanë kaluar nëpër vaksinimin në klasën e parë dhe kanë parë vëllezërit e motrat më të mëdhenj ose miqtë më të mëdhenj duke u vaksinuar, ata e perceptojnë marrjen e vaksinimit kur arrijnë klasën VI si normale. Duke pasur parasysh se shumica e ngjarjeve të padëshiruara pas vaksinimit (EPPV) janë të natyrës psikosomatike (p.sh., alivanosjet) kanë të bëjnë me ankthin rreth vaksinimit, mund të supozohet gjithashtu se vajzat në Kosovë mund të kenë më pak gjasa të përjetojnë episode psikosomatike kur marrin HPV.

5.1.3 Masmedia

Me gjithë shumësinë dhe praninë e mediave private gjatë viteve të fundit në Kosovë, përvojat e fundit me vaksinimin kundër COVID-19 dhe me përgatitjet paraprake për AKMS për përfshirjen e vaksinës kundër HPV (shih seksionin vijues) sugjerojnë që entitetet kryesore të medias kanë raportuar përgjithësisht me përgjegjësi për këto vaksina dhe u kanë bërë pyetje të

arsyeshme autoriteteve shëndetësore për çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë e vaksinave dhe modalitetet e zbatimit. Prandaj, një nivel i arsyeshëm i bashkëpunimit me mediat kryesore mund të parashikohet për përfshirjen e vaksinave shtesë (përfshirë HPV), përmes komunikimit transparent dhe të rregullt.

Mbështetja e medias nuk mund të supozohet kurrë dhe përvoja nga vendet e tjera ka treguar se motivet politike dhe/ose të bazuara në fitime në rrethana të caktuara mund të kenë përparësi ndaj të mirave publike. Rrjedhimisht, për të mbështetur dhe forcuar besimin e publikut në vaksinat kundër PCV, Rota dhe HPV, do të jetë e nevojshme të ketë angazhim aktiv në media dhe t'u ofrohet subjekteve mediatike informacioni i duhur për vaksinat, duke përfshirë pakot e informacionit për mediat dhe përgjigjet ndaj pyetjeve më të shpeshta.

Rreziku i shfaqjes dhe/ose përhapjes së dezinformatave rreth vaksinave dhe ndjenjave kundër vaksinimit mund të zbutet vetëm nëse publiku është i informuar mirë për efikasitetin, sigurinë dhe arsyetimin për përfshirjen e këtyre vaksinave shtesë (veçanërisht vakcina HPV). Dezinformimi dhe thashethemet negative lulëzojnë kur njerëzit lihen në errësirë për informacion, prandaj dhe si të tillë do të jetë e nevojshme të ketë një qasje pro-aktive për të siguruar që publiku, mësimdhënësit, prindërit dhe të gjithë akterët kryesorë do të marrin informacionin e saktë dhe informacionin që u nevojitet për vaksinim.

5.1.4 Mediat sociale

Mediat sociale në Kosovë, si edhe në vendet e tjera, janë më pak të parashikueshme, më të rrjedhshme, më të shpejta, të parregulluara dhe më të pa qëndrueshme se sa mediat e shkruara dhe audio-vizuele. Prandaj, pavarësisht nga niveli relativisht i lartë i pranimit të vaksinimit nga publiku në Kosovë, mundësia e shfaqjes, qarkullimit të ndjenjave kundër vaksinimit dhe më pas minimi të besimit në vaksinim nuk mund të zhvlerësohet tërësisht. Gjatë pandemisë COVID-19, sentimente kundër vaksinimit që qarkullonte në mediat sociale ishte i kufizuar dhe kishte pak ndikim në mbulueshmërinë me vaksinim. Megjithatë, ka një sërë skenarësh të mundshëm që mund të shkaktojnë një përshkallëzim të mbulimit negativ të mediave sociale në lidhje me prezantimin e vaksinës kundër PCV, Rota dhe (veçanërisht) HPV. Edhe pse gjasat janë të vogla për të ndodhur, disa nga këto rrethana potenciale, mund të përfshijnë:

- Veprime të qëllimshme, të planifikuara mirë të ndërmarra nga akterët e mediave sociale me qëllim për të minuar besimin e publikut në vaksinim.
- Qarkullimi arbitrar ose sensacional i thashethemeve që kanë të bëjnë, për shembull, me sigurinë e vaksinave, origjinën e vaksinës, komplotet e vaksinave dhe efektet anësore të vaksinës që rezultojnë në një efekt topi bore ku gjithnjë e më shumë individë postojnë, komentojnë dhe përhapin dezinformata dhe thashetheme.
- Keqinterpretimi i ngjarjeve të padëshiruara pas vaksinimit (EPPV) në mediat kryesore ose në mediat sociale, që rezulton në përshkallëzimin e shqetësimeve të publikut për vaksinat. Për shembull, alivanosjet pas vaksinimit (të rralla, por jo të padëgjjuara) që keqinterpretohen në media si një reagim serioz kërcënues për jetën, ose mësimdhënësit dhe autoritetet shëndetësore që reagojnë tepër efekteve të padëshiruara pas vaksinimit bëhen temë lajmesh apo raportimi mediatik.
- Manipulimi i opinionit publik për qëllime komerciale ose politike nga media apo akterët e mediave sociale

Në këtë kontekst, përgatitja për shfaqjen ose përshkallëzimin e sentimentit kundër vaksinimit, shfaqjen e dezinformimit dhe thashethemeve të dëmshme, si dhe dëmeve që kjo mund të sjellë për besimin në vaksinim, është thelbësor, edhe nëse rreziku për të ndodhur kjo vlerësohet si i ulët.

5.1.5 Vaksinimi për popullatën vulnerabile

Për popullatat vulnerabile, grupet e pakicave etnike dhe vajzat 12 vjeçare që nuk ndjekin arsimin dëshmitë sugjerojnë se do të kërkojnë përpjekje shtesë për t'i arritur këto grupe/popullata me informacion dhe mesazhe kyçe. Mbulimi i përgjithshëm i vaksinimit në mesin e popullatave vulnerabile është dukshëm më i ulët se për popullatën e përgjithshme dhe lidhet me disavantazhin, sfidat e qasjes në kujdesin shëndetësor parësor, nivelet më të ulëta të regjistrimeve në shkollat e mesme të ulët në mesin e vajzave të grupeve të marginalizuara, nivelet më të larta të braktisjes së shkollës, si dhe normat sociale dhe kulturore të cilat mund të dëmtojnë pranimin e vaksinave. Si e tillë, do të nevojiten ndërhyrje specifike për të nxitur marrjen e vaksinave në mesin e këtyre popullatave, dhe për vaksinën kundër HPV.

5.1.6 Komunikimi i brendshëm dhe me palët e interesit

Cilësia dhe efektiviteti i komunikimit dhe koordinimit të brendshëm dhe ndër-sektorial dhe brenda shëndetësisë, dhe ndërmjet palëve kryesore të interesit, është treguar shumë i rëndësishëm gjatë implementimit të përfshirjes së vaksinave shtesë. Përvojat nga vendet e tjera sugjerojnë se komunikimi i dobët i brendshëm dhe i palëve të interesit, dhe respektimi i dobët i protokolleve të komunikimit për të cilat është rënë dakord (përfshirë sigurimin e konsistencës së mesazheve kryesore dhe përgjegjësitë për raportim mund të dëmtojë zbatimin efektiv të iniciativave të përfshirjes së vaksinës, ose të çojë në situata ku për shembull, përgjigjet e AKMS nuk janë adekuate, në kohë ose të kuptueshme mirë, janë të cilësisë së dobët ose me intensitet të pamjaftueshëm. Konsultimet e ndërmarra për zhvillimin e Planit për AKMS sugjerojnë se komunikimi i brendshëm dhe i palëve të interesit në nivele të ndryshme, dhe ndërmjet sistemeve, akterëve është adekuat dhe më i mirë se disa vende të tjera ku vaksinat shtesë janë përfshirë me sukses. Megjithatë, do të jetë thelbësore të sigurohet një mbikëqyrje efektive e komunikimit, jo vetëm për aktivitetet "tradicionale" të AKMS, por edhe në lidhje me komunikimin dhe raportimin e strukturuar dhe rutinë për të siguruar zbatimin efektiv; dhe për komunikimet e jashtëzakonshme, raportimin dhe veprimet e AKMS që mund të kërkojnë në rast të shfaqjes ose përshkallëzimit të hezitimit publik ndaj vaksinimit.

5.1.7 Sigurimi i transparencës për vaksinën HPV

Së fundi, konsultimet me palët e interesit kanë zbuluar disa divergjenca opinionesh në lidhje me sa intensive duhet të jenë veprimet e AKMS dhe sa informacion duhet t'u jepet prindërve në lidhje me vaksinën HPV. Siç u përmend më herët, vakcina HPV parandalon përhapjen e Human Papilloma Virusit, një infeksion seksualisht i transmetueshëm, dhe janë ngritur shqetësime se segmentet më konservatore të shoqërisë mund të reagojnë negativisht ndaj prezantimit të informacionit për marrëdhënien midis infeksionit HPV dhe kancerit të qafës së mitrës ose sugjerime që vajzat e tyre kanë nevojë për këtë vaksinë ose janë vërejtur gjithashtu

shqetësime, reagime ndaj informacionit që çojnë në stigmatizimin e vaksinës në disa komunitete dhe një hezitim për t'i kushtuar vëmendje çdo informacioni shtesë të ofruar.

Megjithatë, konsiderata më të rëndësishme për planifikuesit e AKMS lidhet më shumë me mënyrën se si ndahet informacioni i ndjeshëm në kontekstin e caktuar socio-kulturor. Siç u argumentua më parë në këtë pjesë, dezinformatat dhe thashethemet lulëzojnë dhe përhapen në një vakum informacioni dhe kur njerëzit nuk janë të informuar për përfitimet e vaksinës. Si i tillë, është qëndrimi i konsideruar i këtij Plani dhe për shumicën e palëve të interesit që informuan zhvillimin e këtij plani - që informacioni i detajuar në lidhje me Human Papilloma Virusin dhe lehtësinë dhe shpeshësinë e transmetimit të tij duhet të ndahet me shumicën e prindërve gjatë përgatitjeve për zbatim. Ekziston rreziku që shqetësimi që disa prindër kanë ndaj vaksinës mund të veprojë si element dekurajues për vaksinimin e fëmijës së tyre, ekziston një rrezik më i madh nëse ky informacion nuk bëhet gjerësisht i disponueshëm dhe hapësira për thashethemet për të qarkulluar mbetet e pakontrolluar.

6. ARRITJA E OBJEKTIVAVE-PARIMET DHE VEPRIMET E PLANIT TË KOMUNIKIMIT

Një qasje me faza ndaj AKMS për tre vaksinat shtesë do të ndërmerret për t'u siguruar që prindërit dhe palët kryesore të interesit që angazhohen me prindërit (shpesh vetë prindërit dhe duke përfshirë vaksinuesit, mësimmshënësit, profesionistët shëndetësor dhe përfaqësuesit e medias) do të ndërgjegjësohen në mënyrë progresive për përfitimet e vaksinës kundër PCV-së, Rota dhe HPV. Kjo qasje rekomandohet për të mos alarmuar prindërit dhe publikun duke i kushtuar vëmendje të hapur ose të tepruar këtyre tre vaksinave (sidomos vaksinës HPV) në fazat e hershme që rrezikon të largojë prindërit dhe të krijojë përshtypjen se vaksinat janë të veçanta në një farë mënyre duke u imponuar fëmijëve dhe familjeve të tyre nga shteti. Megjithatë, siç u argumentua në seksionin e mëparshëm, hulumtimi formativ sugjeron që njerëzit duan më shumë informacion rreth vaksinave (vaksina HPV në veçanti) dhe duhet të sigurohen se vaksinat janë të sigurta dhe efektive. Si i tillë, Plani i AKMS sugjeron një qasje shkallëzuese, por të qëndrueshme për ndërgjegjësimin e publikut për efikasitetin dhe sigurinë e vaksinës, për të siguruar pranim dhe qëndrueshmëri afatgjatë.

Siç detajohet në matricën e Plani të AKMS (shih Pjesën 7), veprimet dhe proceset e AKMS për këtë strategji do të zbatohen në tre faza të veçanta. Faza 1: fillimi i nëntorit 2023 deri në mes të dhjetorit 2023; Faza 2: mesi i dhjetorit 2023 deri në fund të janarit 2024; dhe Faza 3 që mbulon veprimet e AKMS gjatë zbatimit (nga fundi i janarit 2023 deri në fund të 2024). Megjithatë, disa veprime të caktuara të AKMS do të fillojnë në fazën e parë dhe do të përfundojnë në fazën e dytë, ndërsa të tjerat aktivitete (p.sh. monitorimi i mediave sociale) do të zhvillohen në vazhdimësi dhe do të duhet të vazhdojnë edhe në fazën e zbatimit.

6.1.1 Përgatitjet e ndërmarra

Siç u përmend në hyrje, vaksinat CV dhe Rota u përfshinë në skemën e vaksinimit të rregullt në tetor të vitit 2023 dhe deri tani prindërit kanë mirëpritur vaksinat dhe shpjegimet e dhëna nga profesionistët shëndetësor në lidhje me rëndësinë e këtyre vaksinave dhe efikasitetin e tyre.

Për vaksinën HPV janë bërë disa përgatitje që lidhen me komunikim, krahas sigurimit të furnizimit me vaksina dhe përcaktimit të modaliteteve të zbatimit. Këtu përfshihen:

- Organizimi i një konference kombëtare të ekspertëve në Prishtinë për të informuar komunitetin mjekësor rreth planit për përfshirjen e tre vaksinave kundër PCV, Rota dhe HPV në Kalendarin e rregullt të vaksinimit. Konferenca u ndoq nga profesionistët shëndetësor, përfaqësuesit e institucioneve relevante dhe partnerë ndërkombëtarë. Agjencitë mediatike ishin gjithashtu të ftuara, dhe mbulimi i konferencës ishte i balancuar dhe mbështetës.
- Realizimi (gusht-nëntor 2023) i trajnimeve kaskadë për profesionistët shëndetësorë për tri vaksinat shtesë. Me mbështetjen e OBSH-së, këto trajnime që nga 1 nëntori janë zhvilluar në shumicën e komunave (janë trajnuar rreth 783 profesionistë shëndetësor (306 mjekë dhe 477 infermierë) dhe caku ka qenë që gjithsej 1140 punonjës shëndetësorë të jenë trajnuar deri në dhjetor 2023. Këto janë trajnime rifreskuese për vaksinat e Kalendarit të rregullt të vaksinimit; për tre vaksinat e reja; trajnim për vaksinimin catch-up; dhe trajnimi për raportim të efekteve të padëshiruara të vaksinave (EPPV).
- Realizimi i një sërë trajnimesh rifreskuese të punonjësve shëndetësorë mbi komunikimin ndër-personal për vaksinim me profesionistët shëndetësor për vaksinat e reja. Trajnimet janë mbajtur që nga janari 2023 dhe deri në fund të nëntorit 2023 do të arrijnë të trajnohen paktën 1000 profesionistë shëndetësor. Këto trajnime kanë bërë shumë për të siguruar përgatitjen e profesionistëve shëndetësorë për komunikimin me publikun rreth vaksinave të reja. Për vaksinën e HPV-së, veçanërisht këto trajnime kanë mbuluar etiologjinë e kancerit të qafës së mitrës, lidhjen midis papilloma virusit njerëzor dhe kancerit të qafës së mitrës, dëshmi globale mbi efikasitetin e vaksinës HPV, këshilla se si t'i përgjigjemi keqinformimit dhe hezitimit të vaksinave dhe këshilla se si të diskutohet mbi përfitimet e vaksinës me prindërit.
- Angazhimi i medias duke përfshirë sesione pyetje-përgjigje dhe panel diskutime që i kanë mundësuar publikut të informohet nga ekspertët e imunizimit të IKSHP dhe mjekë të tjerë specialistë. Deri më sot, këto paraqitje në media janë pritur mirë dhe nuk është vërejtur asnjë reagim publik ose mediatik apo sentiment kundër vaksinimit.

Përveç kësaj, disa aktivitete të Fazës 1 të AKMS janë përfunduar duke përfshirë rekrutimin e një konsulenti ndërkombëtar për të mbështetur planifikimin e AKMS, realizimin e një punëtorie të bashkë-draftimit me palët kryesore të interesit për të rënë dakord mbi veprimet dhe strategjitë e AKMS në përgatitje për zbatimin e planit, formimin e Grupit punues dhe monitorues për AKMS dhe finalizimin dhe validimin e Planit për AKMS. Për më tepër, më 8 nëntor u mbajt një takim me qëllim informimit në nivel kombëtar mbi Planin e AKMS, implikimet e planit për zbatimin komunal dhe nevojën për monitorim të mediave sociale dhe marrëdhënie të qëndrueshme dhe të mirë menaxhuara me median për shifat e imunizimit në nivel komune që do të ndihmojë për të siguruar lokalizimin dhe planifikimin gjithëpërfshirës për AKMS.

6.1.2 Parimet e planifikimit dhe implementimi

Plani i AKMS mbështetet në disa parime kyçe të cilat zërthehen në veprime specifike brenda matricës së planifikimit në (shih Shtojcën 2). Këtu përfshihen:

- Rëndësia gjithëpërfshirëse dhe kritike e Grupit Monitorues për AKMS dhe roli i tij në mbikëqyrjen e zbatimit të Planit të AKMS, duke udhëhequr aktivitetet komunale dhe duke siguruar komunikim efektiv dhe transparent, reagimin dhe përshtatshmërinë e veprimeve të AKMS si dhe monitorimin e perceptimeve publike.
 - Sigurimi i transparencës në lidhje me komunikimin me publikun, komunikimin e brendshëm brenda sektorit të shëndetësisë, ndërmjet nivelit kombëtar dhe komunal, dhe ndërmjet akterëve kryesorë, përfshirë MASHTI, partnerët ndërkombëtarë dhe mediat.
 - Sigurimi që komunikimi ndërmjet nivelit komunal dhe atij kombëtar të jetë i rregullt, i lidhur me përgjegjësitë dhe konsistent.
 - Sigurimi që i gjithë personeli i sektorit të shëndetësisë dhe arsimit që ka përgjegjësi për të komunikuar rreth vaksinave (duke përfshirë stafin e nivelit komunal) të mbajë veshët dhe sytë hapur dhe të raportojë te Grupi Monitorues për AKMS për reagimet dhe perceptimet e publikut ndaj përfshirjes së vaksinave (veçanërisht vaksinën HPV. Kjo përfshin monitorimin e mediave sociale në baza të rregullta dhe mediat tradicionale dhe monitorimin e diskursit social në nivel komuniteti dhe komune.
 - Ruajtja e fleksibilitetit të reagimit dhe përgatitja në të gjitha nivelet për çdo ndryshim në reagimet publike, duke përfshirë shfaqjen dhe përshkallëzimin e mundshëm të hezitimit ndaj vaksinave ose sentimentit kundër vaksinimit. Në terma praktikë, kjo do të thotë t'i kushtohet vëmendje mediave sociale dhe diskursit të mediave kryesore në nivel kombëtar dhe zhvillimi i nën-strategjive të përshtatshme.
 - Identifikimi i zëdhënësve në nivel kombëtar dhe komunal të cilët mund t'i drejtohen mediave nëse kërkohet, dhe identifikimi i pikave fokale në nivel kombëtar dhe komunal që mund të vihen në dispozicion për t'u përgjigjur shqetësimeve ose kërkesave publike për informacione të mëtejshme për vaksinat shtesë.
-
- Identifikimi gjithëpërfshirës i çështjeve që mund të shqetësojnë potencialisht popullatën lidhur me vaksinimin dhe zhvillimi i pyetjeve dhe përgjigjeve më të shpeshta si dhe mesazheve kryesore, të cilat mund të formojnë bazën e broshurave të zhvilluara për shpërndarje publike, mbi të cilat do të bazohen përgjigjet e stafit të sektorit të shëndetësisë dhe arsimit, të cilët mund t'u kërkohet t'u përgjigjen shqetësimeve ose kërkesave publike për informacion.
 - Identifikimi i studimeve akademike kryesore (me mbështetjen e OBSH-së për shpërndarje tek autoritetet komunale të shëndetësisë dhe arsimit dhe mediave në nivel kombëtar dhe komunal) të cilat trajtojnë sigurinë e vaksinave, efikasitetin e vaksinës dhe përvojat pozitive në vende të tjera evropiane.
 - Mbështetje e mëtejshme e sektorit shëndetësor për prezantimin e vaksinës HPV përmes informimeve dhe seancave informuese me gjinekologë, mjekë familjarë dhe pediatër, onkologë dhe përmes shpërndarjes pakove informuese dhe vegëzave (linqeve) të studimeve përmes Odës së Mjekëve të Kosovës.
 - Sigurimi që stafi i sektorit të shëndetësisë dhe arsimit të “QËNDROJ NË MESAZH”, t'i rezistojë çdo tundimi që mund të ketë për të përcjellë opinione personale dhe të jetë konsistent në mënyrën se si do të trajtojnë shqetësimet e publikut dhe t'u përgjigjet kërkesave për informacion.
 - Mbështetja e shpërndarjes së informacionit te prindërit dhe adresimi i çdo shqetësimi nëpërmjet mbledhjes dhe diskutimeve me sektorin shëndetësor mbi efikasitetin dhe sigurinë e vaksinës HPV me mësimdhënësit dhe përfaqësuesit e prindërve në shkolla

6.1.3 Qasja me faza

Siç u përmend më lart, veprimet AKMS do të zbatohen në tre faza të veçanta. Veprimet dhe përgjegjësitë e AKMS për secilën fazë janë të detajuara në Pjesën 7 të planit, por në një kuptim të përgjithshëm secila fazë ka një theks të ndryshëm, ndërsa disa veprime dhe parime të caktuara janë ndër-sektoriale.

Për Fazën 1, theksi kryesor do të jetë në komunikimin dhe verifikimin e roleve dhe përgjegjësive të AKMS-së në nivel kombëtar dhe komunal, dhe sigurimin e udhëzimeve për të mbështetur komunikimin dhe raportimin efektiv dhe transparent ndërmjet të gjitha palëve të interesit. Përveç kësaj, monitorimi i mediave dhe mediave sociale do të duhet të fillojë (dhe të vazhdojë); Njoftimet dhe video mesazhet e shkurtra si dhe njoftimet për mediat sociale do të duhet të zhvillohen dhe të para pozicionohen; dhe materialet (broshurat dhe përgjigjet për pyetjet më të shpeshta) do të duhet të përgatiten dhe testohen dhe të jenë gati për shpërndarje.

Për Fazën 2, zbatimi i Planit të AKMS do të orientohet drejt angazhimit të drejtpërdrejtë me prindërit përmes sistemit shkollor dhe me popullatat e cenushme përmes komunikimit në terren. Rritja e angazhimit me median përmes sesioneve informuese dhe monitorimi i mediave sociale do të jetë gjithashtu e rëndësishme. Sigurimi i transparencës dhe mbështetja e publikut me informacionin e duhur do të jetë gjithashtu thelbësor.

Për Fazën 3, veprimet specifike të kërkuara AKMS do të ndryshojnë në varësi të nivelit të pranimit të vaksinimit nga publiku dhe nga prindërit, veçanërisht për vaksinën kundër HPV-së. Do të kërkohet më shumë angazhim mediatik dhe shpërndarja e materialeve informuese të testuara dhe transmetuara përmes mediave dhe rrjeteve sociale në rast se shfaqen reagime negative ndaj vaksinimit. Përveç kësaj, MSH dhe IKSHPK do të duhet të konsiderojnë ~~organizimin e trajnimeve shtesë për marrëdhëniet me median në nivel kombëtar dhe komunal~~ për të siguruar një përgjigje të sigurt, të qëndrueshme dhe mjaft intensive nëse ndjenjat kundër vaksinimit fillojnë të përshkallëzohen.

Megjithatë, mund të krijohet gjithashtu një situatë kur kërkesa publike për vaksinën HPV tejkalon kapacitetin për të furnizuar me vaksina dhe MSH dhe IKSHP do të duhet të ritheksojnë qartë përmes kanaleve të komunikimit kombëtar dhe komunal arsyet pse mbulimi është i kufizuar në grupin e synuar, dhe të komunikojë planet e ardhshme për vaksinimin e djemve, vajzave adoleshente dhe grave të reja me vaksinën kundër HPV. Sigurimi i dokumentimit, raportimit dhe publikimit të narrativëve pozitiv dhe përvojave të mira të vaksinimit të vajzave, prindërve dhe popullatave vulnerable do të jetë gjithashtu e rëndësishme për të mbështetur pranimin publik në një afat më të gjatë.

7. MONITORIMI DHE EVALUIMI

Për të gjithë treguesit, duhet të mblidhet një kombinim i të dhënave cilësore dhe sasiore për të verifikuar përputhshmërinë dhe rezultatet.

7.1.1 Monitorimi i zbatimit

Monitorimi i zbatimit është shumë i rëndësishëm dhe paraqet një mjet kyç për të siguruar që veprimet AKMS të identifikuar në këtë Plan të ndërmerren sipas planifikimit dhe kur kërkohet.

Treguesit kryesorë:

- Grupi monitorues për AKMS mbanë takime të rregullta javore, bënë regjistrimin dhe qarkullimin e procesverbaleve të takimit tek palët kryesore të interesit.
- Niveli i përgjithshëm i zbatimit të veprimeve AKMS të detajuara në këtë plan sipas planifikimit kohor.
- Përfundimi i planifikimit në nivel komunal (dhe inkorporimi i tij në mikroplanet e imunizimit në nivel komunal), duke përfshirë emërimin e zëdhënësve komunalë dhe pikave fokale për pyetjet eventuale të prindërve dhe publikut të gjerë.
- Zhvillimi dhe shpërndarja në kohë e broshurave informative për profesionistët shëndetësor, shkollat dhe prindërit.
- Dorëzimi javor i raporteve (sado të shkurtra që të jenë) mbi aktivitetin e mediave sociale në lidhje me vaksinat e reja në nivel kombëtar.
- Zhvillimi në kohë dhe shpërndarja e materialeve informative të ndryshme përmes kanaleve të mediave dhe zhvillimi i përmbajtjes së mesazheve për mediat sociale (në rast të paraqitjes së nevojës) nëse - dhe kur - kërkohet.

7.1.2 Monitorimi i Efektivitetit të Veprimeve të Planit të AKMS

Treguesit kryesorë:

- Niveli i përgjithshëm i implementimit të veprimeve të AKMS të detajuara në këtë plan sipas planifikimit në nivel kombëtar dhe komunal.
- Numri dhe cilësia e lajmeve pozitive të publikuara në mediat kryesore ose të postuara në rrjetet sociale.
- Niveli i përputhshmërisë ndërmjet zëdhënësve kombëtarë dhe rajonalë me mesazhet kyçe dhe konsistenca e përgjigjeve të ofruara për publikun dhe median.
- Reagimi në kohë i Grupit Monitorues për AKMS ndaj thashethemeve negative ose sentimentit kundër vaksinimit nëse ato shfaqen ose përshkallëzohen.
- Efektiviteti i treguar në identifikimin e vajzave që nuk ndjekin arsimin dhe efektiviteti i qasjeve në terren për shtrirjen e vaksinimit te grupet vulnerable.

7.1.3 Monitorimi i rezultateve

Treguesit kryesorë:

- Në fund të vitit 2024, përqindja e vajzave në klasën e VI-të që marrën vaksinën kundër HPV (sipas shkollës dhe komunës)
- Në fund të vitit 2024, përqindja e vajzave të identifikuar që nuk ndjekin arsimin dhe që u vaksinuan kundër HPV.
- Në fund të vitit 2024, përqindja e foshnjave që kanë marrë vaksinën PCV dhe Rota kundrejt popullatave të vlerësuara në nivel komune.

7.1.4 Evaluimi

Për të vlerësuar efektivitetin e veprimeve dhe proceseve të AKMS të ndërmarra për të arritur objektivat përfshirjes së vaksinave PCV, Rota dhe HPV, mbledhja e të dhënave në lidhje me treguesit e sipërpërmendur duhet të respektohet dhe vlerësohet si pjesë e proceseve të Vlerësimit të Pas Zbatimit. Vlerësimi Formal i Pas -Zbatimit duhet t'i kushtojë vëmendje veprimeve të AKMS, efektivitetit të tyre dhe mësimave të nxjerra.

8. ARANZHIMET E ZBATIMIT, MONITORIMIT DHE RAPORTIMIT

Realizimi i aktiviteteve të Planit të Avokimit, Komunikimit dhe Mobilizimit Social për vaksinat e reja në Kalendarin e rregullt të vaksinimit, do të mundësojnë sigurimin e një përgjigje më të mirë të prindërve në vaksinimin e fëmijëve të tyre me këto vakcina të përfshira në kalendar. Qëllimi i monitorimit është ofrimi i raporteve lidhur me zbatimin e Planit të veprimit, bazuar në indikatorët e përcaktuar për secilin aktivitet të cilat do të shërbejnë për vendime të bazuara në dëshmi për MSh-në më rastin e rishikimit të politikave në fushën e vaksinimit.

Bazuar në indikatorët kyç të definuar në Planin e veprimit, Grupi punues për monitorimin e zbatimit të Planit do të monitorojë indikatorët sipas periudhës dhe frekuencës së përcaktuar dhe të njëjtit do t'i raportojë në MSh duke siguruar që institucionet përkatëse të mbahen përgjegjëse për zbatimin e aktiviteteve të planifikuara dhe të bashkëpunojnë mes vete.

Në proces do të përfshihen të gjithë akterët dhe institucionet hisedare të cilat kanë përgjegjësi në procesin e zbatimit të Kalendarit të rregullt të vaksinimit. Ato, janë të obliguara që të shfrytëzojnë kapaciteteve institucionale, procedurat e brendshme dhe mekanizmat e tjera administrativë që lidhin dhe mundësojnë komunikimin e institucioneve shëndetësore dhe arsimore mes vete. Gjithashtu, të përfshira do të jenë edhe Zyrat respektive të Organizatës Botërore të Shëndetësisë dhe të UNICEF-it në Kosovë, bashkë me partnerët dhe palët e tjera të interesit.

Raportimet nga monitorimi do të jenë periodike dhe ato do të përfshijnë zbatimin e aktiviteteve, sfidat e shfaqura në proces dhe rekomandimet për ndryshime eventuale me qëllim të adresimit me kohë të shqetësimeve, përmirësimin e vazhdueshëm dhe rritjen e shkallës së vaksinimit me tre vaksinat e përfshira në Kalendarin e rregullt të vaksinimit.

9. NDIKIMI BUXHETOR DHE ZBATIMI I PLANIT NACIONAL

Zbatimi i Planit për Avokim, Komunikim dhe Mobilizim Social për vaksinat e reja në Kalendarin e rregullt të vaksinimit në Kosovë do të sigurohet përmes mbështetjes financiare nga buxheti i Qeverisë së Republikës së Kosovës, por edhe nga zyrat respektive të UNICEF-it dhe OBSH-së në Kosovë.

Aktivitetet e AKMS janë pjesë integrale e aktiviteteve që shoqërojnë procesin e imunizimit në Kosovë sipas Planit të veprimit 2023-2025 dhe shumica prej tyre realizohen në kuadër të kostos administrative të institucioneve që hartojnë dhe implementojnë procesin e vaksinimit.

Ndërkaq, zyra e OBSH-së dhe e UNICEF-it në Kosovë, në kuadër të asistencës së tyre teknike dhe profesionale për institucionet në Kosovë, do të mbështesin prodhimin e materialeve të ndryshme informuese (broshura, lufleta, posterë, video-mesazhe, info-grafika, etj.), sikurse edhe trajnimet për rritjen e shkathtësive të komunikimit ndër-personal dhe komunikimit me publikun të profesionistëve shëndetësor që ofrojnë shërbime të vaksinimit. Si të tilla, mjetet që këto dy organizata kanë ndarë për mbulimin e këtyre aktiviteteve, në Planin e veprimit do të prezantohen vetëm si asistencë nga ana e tyre.

Plani për Avokim, Komunikim dhe Mobilizim Social, do t'i nënshtrohet gjithashtu vlerësimit të ndikimit financiar për të përcaktuar koston e tij nga Komisioni për kostimin e politikave në Ministri të Shëndetësisë, me qëllim që aktivitetet të kenë mbulim të arsyeshëm financiar dhe të jetë i zbatueshëm në aspektin financiar.

SHTOJCA 1.

Plani i Veprimit për Planin e Avokimit, Komunikimit dhe Mobilizimit Social për tre vaksinat e përfshira në Kalendarin e rregullt të vaksinimit

Aktivitetet	Afati i zbatimit	Kostoja totale	Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës	Institucioni mbështetës	Produkti
1. Planifikimi dhe Koordinimi						
1.1 Krijimi i grupit punues për hartim dhe monitorim të Planit të Komunikimit	2024	Kosto administrative	Qeveria	MSH	IKSHPK, UNICEF	Grupi i themeluar
1.2 Sigurimi i mbështetjes teknike për grupin punues të Planit të Komunikimit	2024	Kosto administrative	Qeveria	IKSHPK	UNICEF/OBSH	Mbështetja teknike e siguruar
1.3 Punëtorja e bashkë-hartimit të Planit të Komunikimit për vaksinat PCV, Rota dhe HPV	2024	Kosto administrative	UNICEF	IKSHPK	MSH	Punëtorja e realizuar
1.4 Plani i Komunikimit për vaksinat e reja i ndarë për komente dhe rishikim	2024	Kosto administrative	Qeveria	MSH	IKSHPK/OBSH/UNICEF	Plani i ndarë për komente dhe rishikim
1.5 Plani i Komunikimit i validuar dhe i shpërndarë në komuna	2024	Kosto administrative	Qeveria	MSH	IKSHPK, KPSH	Plani i validuar dhe shpërndarë në komuna
1.6 Organizimi i Konferencës Kombëtare	2024	Kosto administrative	Qeveria	MSH	IKSHPK/OBSH	Konferenca e organizuar

për përfshirjen e vaksinave PCV, Rota dhe HPV						
1.7 Informimi në nivel kombëtar dhe komunal mbi Planin e Komunikimit	2024	Kosto administrative	Qeveria	MSH	IKSHPK/KPSH/OBSH/UNICEF	Informimi i realizuar në nivelin kombëtar dhe komunal
1.8 Përfshirja e aktiviteteve të Planit të Komunikimit në mikro-planet komunale për imunizim	2024	Kosto administrative	Qeveria	MSH	IKSHPK/Komunat/OBSH/UNICEF	Aktivitetet e Planit të komunikimit të përfshira në mikro-planet komunale për imunizim
1.9 Takimet e rregullta të Grupit Punues për Planin e Komunikimit	2024	Kosto administrative	Qeveria	MSH	IKSHPK/Komunat/OBSH/UNICEF	Takimet e mbajtura
2.0 Ndarja e praktikave më të mira dhe informacionit kyç	2024	Kosto administrative	Qeveria	MSH	IKSHPK/Komunat/OBSH/UNICEF	Ndarja e rregullt e praktikeve të mira
Aktivitetet	Afati i zbatimit	Kostoja totale	Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës	Institucioni mbështetës	Produkti
2. Zhvillimi i materialeve të informimit, edukimit dhe komunikimit						
2.1 Broshura të reja informuese për vaksinat, të testuara dhe të miratuara për: - Ekipet e vaksinimit - Mjekët - Farmacistët - Mësimdhënësit dhe Prindërit	2024	Kosto administrative	OBSH/UNICEF	MSH	IKSHPK/OBSH/UNICEF	Broshurat informuese të përgatitura

2.2 Zhvillimi i pakos informuese për mediat	2024	Kosto administrative	OBSH/UNICEF	MSH	IKSHPK/OBSH/UNICEF	Pakoja informuese e përgatitur dhe shpërndarë
2.3 Zhvillimi i video njoftimeve të shkurta për transmetim në TV	2024	Kosto administrative	OBSH/UNICEF	MSH	IKSHPK/OBSH/UNICEF	Video-njoftimet e përgatitura dhe të shpërndara për transmetim
Aktivitetet	Afati i zbatimit	Kostoja totale	Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës	Institucioni mbështetës	Produkti
3. Komunikimi për sektorin shëndetësor						
3.1 Trajnim për tri vaksinat (PCV, Rota dhe HPV) për profesionistët shëndetësor (PSH)	2024	Kosto administrative	Qeveria	IKSHPK	MSH/KPSH/OBSH/UNICEF	Trajnimi i mbajtur me profesionistët shëndetësor
3.2 Trajnime rifreskuese të komunikimit ndër-personal për profesionistët shëndetësor	2024	Kosto administrative	Qeveria	IKSHPK	MSH/KPSH/OBSH/UNICEF	Trajnimi i mbajtur me profesionistët shëndetësor
3.3 Shpërndarja e materialeve informuese të profesionistët shëndetësor	2024	Kosto administrative	Qeveria	IKSHPK	MSH/UNICEF/OBSH	Materialet e shpërndara
3.4 Sesion informues me gjinekologë, mjekë	2024	Kosto administrative	Qeveria	MSH	SHSKUK/IKSHPK/OBSH/UNICEF	Sesionet e mbajtura me gjinekologë, mjekë

familjar, onkolog dhe peditër						familjar, onkolog dhe peditër
3.5 Monitorimi i disponimit publik dhe dezinformatave rreth vaksinave në të gjitha nivelet e zbatimit	2024	Kosto administrative	Qeveria	MSH	IKSHPK/UNICEF	Raporte të monitorimit/dëgjimit social
3.6 Komunikimi i rregullt ndërmjet komunave, IKSHP-së dhe akterëve kryesorë	2024	Kosto administrative	Qeveria	MSH	IKSHPK/KPSH	Komunikimi i mbajtur rregullisht me akterët kryesorë
Aktivitetet	Afati i zbatimit	Kostoja totale	Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës	Institucioni mbështetës	Produkti
4. Komunikimi për mësimdhënësit dhe prindërit						
4.1 Shpërndarja e broshurave për mësimdhënësit dhe shkollat	2024	Kosto administrative	OBSH	IKSHPK	MSH/ MASHT /UNICEF/	Broshurat e shpërndara për mësimdhënësit
4.2 Shpërndarja e broshurave për prindërit përmes shkollave dhe këshillave të prindërve	2024	Kosto administrative	OBSH	IKSHPK	MSH/ MASHT /UNICEF	Broshurat e shpërndara për prindërit përmes shkollave dhe këshillave të prindërve
4.3 Njoftimi i shkollave për oraret e vaksinimit për klasën e 6-të	2024	Kosto administrative	Qeveria	IKSHPK	MSH/ MASHT /UNICEF	Shkollat e njoftuara me orarin e vaksinimit
4.4 Realizimi i takimeve informuese ndërmjet	2024	Kosto administrative	Qeveria	MSH/MASHT	IKSHPK/KPSH/OBSH/UNICEF	Takime informuese të mbajtura

mësimdhënësve / përfaqësuesve të këshillave të prindërve dhe ekipeve komunale të imunizimit						
4.5 Njoftimi i prindërve për oraret e vaksinimit për klasën e 6-të	2024	Kosto administrative	Qeveria	MSH/MASHT	IKSHPK/KPSH/OBSH/UNICEF	Prindërit të informuar për orarin e vaksinimit për klasat e VI-ta
Aktivitetet	Afati i zbatimit	Kostoja totale	Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës	Institucioni mbështetës	Produkti
5. Komunikimi me mediat						
5.1 Ndarje e informatave për redaktorët e lajmeve dhe gazetarët	2024	Kosto administrative	Qeveria	MSH	IKSHPK/KPSH/OBSH/UNICEF	Informata dhe materiale informuese të ndara me redaktorët e lajmeve dhe gazetarët
5.2 Angazhimi i ekspertëve shëndetësor në sesionet në radio dhe televizion	2024	Kosto administrative	Qeveria	MSH	IKSHPK/MASHT/KPSH/OBSH/UNICEF	Ekspertët të angazhuar për sesion informuese në emisione në media (TV, radio...)
5.3 Zhvillimi dhe testimi i materialeve për TV/Radio	2024	Kosto administrative	Qeveria	MSH	IKSHPK/MASHT/KPSH/OBSH/UNICEF	Materialet informuese të hartuara dhe testuara
5.4 Transmetimi i video materialeve	2024	Kosto administrative	Qeveria	MSH	IKSHPK/MASHT/KPSH/OBSH/UNICEF	Video-materiale të transmetuara në media tradicionale dhe sociale

5.5 Trajnime për marrëdhëniet me mediat për shefat komunalë të imunizimit	2024	Kosto administrative	Qeveria	MSH	IKSHPK/UNICEF/OBSH	Trajnimet e mbajtura për marrëdhëniet me media për shefat komunalë të vaksinimit
5.6 Shënimi i Javës Botërore kundër kancerit të qafës së mitrës (22-28 janar 2024)/ Dita Botërore kundër kancerit (4 shkurt 2024)	2024	Kosto administrative	Qeveria	MSH	IKSHPK/OBSH/UNICEF	Java Botërore kundër kancerit të qafës së mitrës e shënuar Dita Botërore kundër kancerit e shënuar
5.7 Konferenca për media	2024	Kosto administrative	Qeveria	MSH	IKSHPK/MASHT/OBSH/UNICEF	Konferenca për media të mbajtura
Aktivitetet	Afati i zbatimit	Kostoja totale	Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës	Institucioni mbështetës	Produkti
6. Komunikimi përmes mediave sociale						
6.1 Monitorimi i mediave sociale	2024	Kosto administrative	Qeveria	IKSHPK	MSH/OBSH/UNICEF	Raportet nga monitorimi i mediave
6.2 Planifikimi i pakos rezervë për mediat sociale	2024	Kosto administrative	Qeveria	MSH	IKSHPK/MASHT/OBSH/UNICEF	Pakoja rezervë e planifikuar për mediat sociale
6.3 Identifikimi i influencuesve të përgatitur për të mbështetur vaksinimin	2024	Kosto administrative	Qeveria	MSH	IKSHPK/MASHT/OBSH/UNICEF	Influencuesit e identifikuar dhe angazhuar për të mbështetur vaksinimin

6.4 Aktivizimi i pakos rezervë për media sociale	2024	Kosto administrative	Qeveria	MSH	MSH/OBSH/UNICEF	Pakoja rezervë për media sociale e aktivizuar
Aktivitetet	Afati i zbatimit	Kostoja totale	Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës	Institucioni mbështetës	Produkti
7. Komunikimi për grupet vulnerable						
7.1 Identifikimi i vajzave që nuk ndjekin shkollimin	2024	Kosto administrative	Qeveria	MASHT	MSH/IKSHPK	Vajzat që nuk ndjekin shkollimin të identifikuar
7.2 Puna në terren për të mbështetur vaksinimin e vajzave jashtë sistemit shkollor nga grupet vulnerable (vaksinimi kundër HPV)	2024	Kosto administrative	Qeveria	IKSHPK	MSH/UNICEF/OBSH	Vaksinimi në terren i vajzave që nuk e ndjekin shkollimin me vaksinën kundër HPV
7.3 Puna në terren për të mbështetur vaksinimin e foshnjave (përfshirë PCV / Rota) nga grupet vulnerable	2024	Kosto administrative	Qeveria	IKSHPK	MSH/SHSKUK/KPSH/UNICEF/OBSH	Raportet për vaksinimin në terren të foshnjave nga grupet vulnerable

SHTOJCA 2: Plani operacional i punës

Komunikimi për përfshirjen e vaksinave PCV, Rota dhe HPV - Plani i Veprimit (nëntor 2023 - përfundimi 2024)																
1. Planifikimi dhe Koordinimi																
STATUSI DHE KODET E ORARIT		KOMPLETUAR			VEPRIM ME PRIORITET				SIPAS NEVOJËS			NË VAZHDIMËSI				
VEPRIMI	QËLLIMI	NIVELI	STATUS I / FAZA	ORARI								PËRGJEGJËSI A	BUXH ET	SHËNIME		
				NËNTOR 2023		DJETOR 2023		JANAR 2024		SHKURT 2024 sipas nevojës						
1.1 Krijimi i grupit punues për hartim dhe monitorim të Planit të Komunikimit	Koordinimi Menaxhimi Planifikimi	Nacionale	FAZA NJË											MSh/IKSHP		
1.2 Sigurimi i mbështetjes teknike për grupin punues të Planit të Komunikimit	Koordinimi i inputeve dhe i komunikimit ndërmjet palëve të interesit dhe komunave. Mbikëqyr mbledhjen e të dhënave për monitorim të planit	Nacionale	FAZA NJË											Grupi punues për monitorim/ IKSHP	Kosto administrative	Zyrtari i identifikuar nga IKSHP do të punojë me zyrtaren e komunikimit në MSh dhe shefat komunal të imunizimit për të siguruar që veprimet e planit të komunikimit janë në rrugën e duhur
1.3 Punësoria e bashkë-hartimit të Planit të Komunikimit për vaksinat PCV, Rota dhe HPV	Lehtësimi i planifikimit për implementimin e Planit të Komunikimit	Nacionale	FAZA NJË											Grupi Punues për monitorim / UNICEF		
1.4 Plani i Komunikimit për vaksinat e reja i	Të lehtësojë planifikimin për	Nacionale	FAZA NJË											Grupi Punues për monitorim / UNICEF		

STATUSI DHE KODET E ORARIT		KOMPLETUAR		VEPRIM ME PRIORITET				SIPAS NEVOJËS		NË VAZHDIMËSI	
VEPRIMI	QËLLIMI	NIVELI	STATUS I / FAZA	ORARI				PËRGJEGJËSI A	BUXH ET	SHËNIME	
				NËNTOR 2023	DJETOR 2023	JANAR 2024	SHKURT 2024 sipas nevojës				
4.1 Shpërndarja e broshurave për mësimdhënësit dhe shkollat	Të sigurojë informacionin kyç	Nacionale	FAZA DY							IKSHP / MASHTI/ UNICEF	
4.2 Shpërndarja e broshurave për prindërit përmes shkollave dhe këshillave të prindërve	Të sigurojë informacionin kyç dhe pikat e kontaktit në komuna	Komuna	FAZA DY							IKSHP/ UNICEF/MASHT I	
4.3 Njoftimi i shkollave për oraret e vaksinimit për klasën e 6-të		Nacionale/ Komuna	FAZA DY							Ekipe të komunale të vaksinimit	Së paku 2 javë paraprakisht
4.4 Realizimi i takimeve informuese ndërmjet mësimdhënësve / përfaqësuesve të këshillave të prindërve dhe ekipeve komunale të imunizimit	Rritja e mbështetjes dhe ndërgjegjësimit të prindërve për vaksinim	Komuna	FAZA NJË/DY							IKSHP/ UNICEF / Partneri implementues / Shkollat / Ekipe të imunizimit/	
4.5 Njoftimi i prindërve për oraret e vaksinimit për klasën e 6-të	Lehtësimi i vaksinimit	Komuna	FAZA DY							Shkollat/Këshillat e prindërve	

Komunikimi për përfshirjen e vaksinave PCV, Rota dhe HPV - Plani i Veprimit (nëntor 2023 - përfundimi 2024)

5. Komunikimi me mediat

STATUSI DHE KODET E ORARIT		KOMPLETUAR	VEPRIM ME PRIORITET				SIPAS NEVOJËS				NË VAZHDIMËSI							
VEPRIMI	QËLLIMI	NIVELI	STATUS I / FAZA	ORARI												PËRGJEGJËSI A	BUXH ET	SHËNIME
				NËNTOR 2023			DJETOR 2023			JANAR 2024			SHK 2024 sipas nevojës					
5.1 Ndarje e informatave për redaktorët e lajmeve dhe gazetarët	Të marrë mbështetje nga media për të ndërtuar besimin ndaj vaksinës		FAZA NJË / DY													IKSHP/ /OBSh/ UNICEF		Pakot e informimit mund të shpërndahen si para ashtu edhe gjatë takimeve me media
5.2 Angazhimi i ekspertëve shëndetësor në sesionet në radio dhe televizion	Të ndërtojë besimin ndaj vaksinave dhe të shpërndajë informacionin kyç		NË VAZHDI MËSI													IKSHP		
5.3 Zhvillimi dhe testimi i materialeve për TV/Radio	Përgatituni për të siguruar publikun nëse është e nevojshme		FAZA NJË													IKSHP/ UNICEF		
5.4 Transmetimi i video materialeve	Ngritja e besimit të publikut në vaksinim															Grupi punues për monitorim/ IKSHP/ UNICEF		Transmetohet sipas nevojës
5.5 Trajnime informuese për marrëdhëniet me mediat për shefat komunalë të imunizimit	Të ngre kapacitetet e shefave të imunizimit për marrëdhëniet me mediat		FAZA NJË													Grupi punues për monitorim / IKSHP/ UNICEF		-Komunat të identifikojnë zëdhënësit për media
5.6 Shënimi i Javës Botërore kundër kancerit të qafës së mitrës (22-28 janar 2024)/ Dita Botërore	Të ngre vetëdijen e publikut për kancerin e qafës së mitrës															Grupi punues për monitorim / IKSHP		

SHTOJCA 3: Zhvillimi i materialeve

Të gjitha materialet e zhvilluara për shpërndarje, transmetim, informime mediatike dhe informim publik do të duhet të trajtojnë çështjet e mëposhtme në një stil të përshtatshëm për audiencën të ndryshme, me informacion më të detajuar për palët e interesit. Grupi Monitorues për Planin e AKMS në bashkëpunim me OBSH-në dhe UNICEF do të duhet t'i kushtojë vëmendje përmbajtjes dhe detajeve të dhëna (para-testimi dhe grupet e fokusit mund të konsiderohen të nevojshme për të validuar materialet).

Çështjet që duhen trajtuar përfshijnë:

- Efikasiteti dhe përfitimet e vaksinës (të gjitha vaksinat shtesë).
- Siguria e vaksinës (të gjitha vaksinat shtesë).
- Efektet anësore të vaksinës (të gjitha vaksinat shtesë – me fokus në HPV).
- Përvojat e vaksinave në vende të tjera evropiane (të gjitha vaksinat shtesë – me fokus në HPV).
- Efikasiteti i vaksinimit në nivel popullsie (të gjitha vaksinat shtesë – me fokus në HPV).
- Shpjegime në lidhje me mekanizmin e vaksinës për parandalim të sëmundjeve (të gjitha vaksinat shtesë – me fokus në HPV).
- Informacion në lidhje me lehtësinë e transmetimit të HPV-së dhe si lidhet kjo me nevojën për vaksinimin e të gjitha vajzave në klasën e VI-të.
- Informacione për regjistrimin, licencimin dhe prodhimin e vaksinave (të gjitha vaksinat shtesë – me fokus në HPV).
- Akterët dhe partnerët e imunizimit në Kosovë dhe interesat e tyre në promovimin e vaksinimit (të gjitha vaksinat shtesë – me fokus në HPV).
- Për vaksinën kundër HPV-në, kufizimet e furnizimit me vakcina dhe arsyetimi për synimin e vajzave në klasën e VI-të.
- Planet e ardhshme për vënien në dispozicion të vaksinës kundër HPV për vajzat adoleshente, djemtë dhe gratë e reja (sipas nevojës).
- Eksperiencat pozitive të vajzave dhe prindërve me vaksinimin kundër HPV.
- Burime të provave shkencore për sigurinë dhe efikasitetin e vaksinës (të gjitha vaksinat shtesë – me fokus në HPV).
- Çdo shqetësim specifik që mund të lindë në komunitetin mjekësor gjatë zbatimit.

Shtojca 4: Korniza për Monitorim dhe Vlerësim

Objektivat:

1. Të mbështes monitorimin për përmirësim dhe adaptim të vazhdueshëm të planit.
2. Të sigurojë llogaridhënie dhe transparencë në zbatimin e planit AKMS.
3. Të vlerësojë efektivitetin dhe efikasitetin e Planit të AKMS.

TREGUESI	DEFINIMI	BAZA	TARGETI	BURIMI I TË DHËNAVE	FREKUENCA	PËRGJEGJËSIA	RAPORTIMI te
Monitorimi i implementimit							
Organizimi i takimeve të grupit të monitorimit për AKMS	Numri i takimeve të mbajtura me anëtarët e grupit monitorues për AKMS për të monitoruar progresin e zbatimit të Planit AKMS për tre vaksinat e reja.	0	10	Minutat e Takimit	Në baza tre mujore	Grupi për monitorim për AKMS/IKSHPK	Grupi për monitorimin e zbatimit të Planit për AKMS për tre vaksinat e reja
Raportet e monitorimit të mediave sociale për tre vaksina të reja të hartuara dhe të ndara me Grupin e Monitorimit për planin AKMS	Numri i raporteve të zhvilluara të monitorimit të mediave sociale - duke analizuar përmbajtjen në internet dhe sentimentin e publikut ndaj tri vaksinave të reja. Raportet hartohen dhe ndahen me palët kryesore të interesit.	0	6	Shënimet e projektit	Në baza tre mujore	MSH/IKSHPK/UNI CEF	Grupi për monitorimin e zbatimit të Planit për AKMS për tre vaksinat e reja

Sesione informuese për vaksinën HPV me mësimdhënës dhe prindër në shkollat e mesme të ulëta	Numri i mësimdhënësve dhe përfaqësuesve të prindërve që kanë marrë pjesë në sesionet informuese të zhvilluara për vaksinën HPV në shkollat e mesme të ulëta nga profesionistët e shëndetësor.	0	8,000	Shënimet e projektit	Në baza tre mujore	Grupi për monitorim për AKMS/IKSHPK	Grupi për monitorimin e zbatimit të Planit për AKMS për tre vaksinat e reja
Profesionistët shëndetësor të trajnuar për aftësitë e komunikimit ndër-personal për vaksinim	Numri i profesionistëve shëndetësor të trajnuar për aftësitë e komunikimit ndër-personal për vaksinim, duke përfshirë tre vakcina të reja (PCV, Rota dhe HPV) bazuar në paketën e trajnimit IPC.	0	1000	Shënimet e projektit	Në baza tre mujore	Grupi për monitorim për AKMS/IKSHPK	Grupi për monitorimin e zbatimit të Planit për AKMS për tre vaksinat e reja
Punëtori me gazetarë dhe redaktorë të mediave për përfshirjen e tri vaksinave të reja	Numri i gazetarëve dhe redaktorëve të medias të informuar nga IKSHP për përfshirjen e tri vaksinave të reja në kalendarin e rregullt të vaksinimit	0	20	Shënimet e projektit	Në baza tremujore	Grupi për monitorim për AKMS/IKSHPK	Grupi për monitorimin e zbatimit të Planit për AKMS për tre vaksinat e reja
Materialet e IEK (informimit, edukimit he komunikimit) të zhvilluara për tri vaksinat e reja në formate të ndryshme të përshtatura për audiencat të ndryshme	Numri i materialeve të IEK të zhvilluara me përmbajtje të përshtatur për audiencat e synuara, duke përfshirë prindërit/mësimdhënësit, profesionistët shëndetësorë, median dhe publikun e gjerë. Materialet e IEK përfshijnë: broshurat, paketat e mediave sociale,	0	10	Shënimet e projektit	Në baza tre mujore	Grupi për monitorim për AKMS/IKSHPK	Grupi për monitorimin e zbatimit të Planit për AKMS për tre vaksinat e reja

	pakot e informimit të mediave, videot, etj.						
Monitorimi i efektivitetit							
Përqindja e veprimeve të planit të AKMS të zbatuara sipas planifikimit	Përqindja e numrit të përgjithshëm të aktiviteteve të planifikuara në AKMS që janë përfunduar sipas afateve kohore të përcaktuara në Planin e Punës	0	Së paku 80%	Minutat e Takimit	Mujore	Grupi për monitorim për AKMS/IKSHPK	Grupi për monitorimin e zbatimit të Planit për AKMS për tre vaksinat e reja
Materialet IEK për tre vaksina të reja të shpërndara tek audiencat e synuara	Numri i materialeve të IEK për tre vaksina të reja me përmbajtje të përshtatur për audiencat të ndryshme (mësimdhënës/prindër, profesionistë shëndetësor, gazetarë) të shpërndara. Numri i materialeve të shpërndara dhe vendndodhjet e shpërndarjes.	0	20,000	Shënimet e projektit	Në baza tremujore	Grupi për monitorim për AKMS/IKSHPK	Grupi për monitorimin e zbatimit të Planit për AKMS për tre vaksinat e reja
Angazhimi i arritur përmes shpërndarjes së pakos në media sociale	Numri i "reach", pëlqimeve, ndarjeve, komenteve dhe shikimeve në postimeve. Angazhimi i përgjithshëm mund të llogaritet si shumë e metrikave individuale.	0	100,000	Analiza mediave sociale	Në baza tre mujore për broshurat dhe në baza mujore për mediat sociale	Grupi Monitorues për Planin AKMS/Zyrtar i Komunikimit në MSH dhe IKSHP	Grupi për monitorimin e zbatimit të Planit për AKMS për tre vaksinat e reja
Monitorimi i rezultateve							

<p>Përqindja e popullsisë së synuar të vaksinuar (vaksina PCV, Rota dhe HPV)</p>	<p>Përqindja e individëve në popullatat e synuara që janë vaksinuar. Për vaksinën Rota për qindja e fëmijëve të moshës 2, 4 muaj të vaksinuar. Për vaksinën PCV për qindja e fëmijëve të moshës 2, 4 dhe 12 muajsh të vaksinuar. Për vaksinën HPV për qindja e vajzave në klasën VI të vaksinuara.</p>	<p>0</p>	<p>Rota – 92% PCV – 92% HPV – 90%</p>	<p>Shënimet shëndetësore; Raportet e vaksinimit</p>	<p>Dy-vjetor</p>	<p>Grupi për monitorim për AKMS/IKSHPK</p>	<p>Grupi për monitorimin e zbatimit të Planit për AKMS për tre vaksinat e reja</p>
<p>Për qindja (numri) i vajzave jashtë shkollës të vaksinuara për HPV</p>	<p>Për qindja e vajzave të moshës 12 vjeç të vaksinuara për HPV përmes aktiviteteve në terren me popullatat e cënueshme</p>	<p>0</p>	<p>HPV – 90%</p>	<p>Raportet e vaksinimit nga terreni</p>	<p>Dy-vjetor</p>	<p>Grupi për monitorim për AKMS/IKSHPK/OJQ</p>	<p>Grupi për monitorimin e zbatimit të Planit për AKMS për tre vaksinat e reja</p>